

**REPUBLIKA E SHQIPËRISE**  
**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONARËVE E**  
**SH.A UJËSJELLËS POLIÇAN**

**VENDIM**

Sot, me date 22./05./ 2014, Asambleja e përgjithshme e Aksionareve e shoqërisë tregtare SH.A “Ujesjelles Poliçan”, shoqëri e regjistruar si person juridik pran QKR-se, e identifikuar me NIPT-in J691024461, bazuar në të drejtat dhe detyrimet që i jep ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” dhe statuti i shoqërisë, pasi mori në shqyrtim pasqyrat financiare vjetore të vitit 2013, raportin e ecurisë së veprimtarisë të ushtrimit dhe raportin e auditimit të Eksperteve Kontabel të Regjistruar për këto pasqyra financiare


**VENDOSI:**

1. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore, raportin e ecurisë së veprimtarisë të ushtrimit 2013 si dhe raportin e auditimit të Eksperteve Kontabel të Regjistruar për këto pasqyra financiare.
2. Humbja e rezultuar në pasqyrat financiare të ushtrimit 2013 prej 30.537.602 leke të mbulohet nga fitimet e ushtrimeve të ardhshme.
3. Për auditimin e pavarur të pasqyrave financiare të ushtrimit 2014 të emerojë:
  - Z.Dhimo Dundo, Ekspert Kontabel i Regjistruar me licencë profesionale nr.8 datë 11.01.2000 dhe me NIPT K32515098E.
  - “AS-Audit Services” sh.p.k, me NIPT L11813002E dhe ortak kryesor angazhimi Ekspertin Kontabel të Regjistruar z. Afrim Suli.
4. Të ngarkojë Administratorin e shoqërisë për depozitimin e këtij vendimi në regjistrin tregtar pranë Qendres Kombëtare të Regjistrimit (QKR) dhe në Drejtorinë Rajonale Tatimore brenda afateve të përcaktuara.

**AKSIONARËVE E SH.A UJËSJELLËS POLIÇAN**

**ANETAR I ASAMBLESE**

**NOVRUZ LLANGO**




**ANETAR I ASAMBLESE**

**SULEJMAN DERVISHI**



**KRYETAR I ASAMBLESE SE AKSIONARËVE TE SH.A UJËSJELLËS POLIÇAN**

**ADRIATIK ZOTKAJ**

 2014

Emertimi dhe Forma Ligjore **“UJESJELLES POLIÇAN” Skrapar**

*Shoqeri anonime*

**NIPT-I**

*J69102446I*

**Adresa e Selise**

*Polican Skrapar*

**Data e krijimit**

*29.01.2001*

**Nr. i Rregjistrimit Tregtar**

*26.593*

**Veprimtaria kryesore**

*Grumbullimi, perpunimi dhe  
shperndarja e ujit te pijshem*

## **PASQYRAT FINANCIARE**

***Viti 2013***

***Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare***

***Nga 01.01.2013 Deri 31.12.2013***

DATA E MBYLLJES SE PASQYRAVE FINANCIARE 24.03.2014

PASQYRAT FINANCIARE JANE INDIVIDUALE INDIVIDUALE

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE KONSOLIDUARA jo

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE SHPREHURA NE LEKE

PASQYRAT FINANCIARE JANE TE RRUMBULLAKOSURA NE O LEKE

Dhimo Dundo  
Liçenca profesionale  
Nr.8, date 11. 01.2000

Afrim Suli  
Liçenca profesionale  
Nr.4, date 11. 01.2000

"Shtëpia e ushtarakeve",  
Kat.3/2,Berat  
Cel: 069 20 99 204 /069 20 99 204  
Tel/fax: (032) 238360  
E-mail: [dhimo.dundo@hotmail.com](mailto:dhimo.dundo@hotmail.com)  
[afrim.suli@hotmail.com](mailto:afrim.suli@hotmail.com)

## **Raport i Audituesve të Pavarur**

**Për Aksioneret e shoqërisë "UJESJELLESI POLIÇAN" sh.a**  
**Adresa e selise: Poliçan,Skrapar**

*Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkangjitur të shoqërisë "UJESJELLESI POLIÇAN" sh.a, të cilat përfshijnë bilancin kontabel të datës 31 Dhjetor 2013 dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e fluksit të parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin mbyllur në këtë datë, një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël,si dhe informacionin tjetër shpjegues.*

### **Përgjegjësia e drejtimit për Pasqyrat Financiare**

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standartet Shqipëtare të Raportimit Financiar(SKK-të), dhe për ato kontrole të brendëshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale,qoftë për shkak mashtrimit apo gabimit.

### **Përgjegjësia e Audituesit**

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kerkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit,përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo të gabimit.Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendëshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendëshëm të entitetit.

## Ekspert Kontabël të Regjistruar

Nje auditim përfshin gjithashtu, vlerësimin e përshtatëshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithëshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që evidenca e auditimit që ne kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatëshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

### Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyre të drejtë, pozicionin financiar të shoqërisë "UJESJELLESË POLIÇAN" sh.a, më datën 31 Dhjetor 2013, performancën e saj financiare dhe flukset e parasë për vitin e mbyllur, në përputhje me Standartet Shqipëtare të Raportimit Financiar(SKK-të).

## Ekspert Kontabël të Regjistruar



"UJESJELLES POLICAN" SHA

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

Pasqyra e bilancit kontabel me 31.12.2013

	ZERI I BILANCIT	She nime	Viti ushtrimor 2013	Ushtrimi paraardhes 2012
<b>A</b>	<b>AKTIVET</b>			
<b>I</b>	<b>Aktivët Afatshkurtëra</b>			
<b>1</b>	<b>Mjete monetare</b>	<b>3</b>	<b>591,505</b>	<b>333,570</b>
<b>2</b>	<b>Derivative dhe aktive financiare të mbajtura për tregtim</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
(i)	-Derivatet		0	0
(ii)	-Aktivet e mbajtura për tregtim		0	0
	<b>Totali 2</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>3</b>	<b>Aktive të tjera financiare afatshkurtra</b>			
(i)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme	4	12,968,453	10,390,036
(ii)	Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme	5	995,690	298,704
(iii)	Instrumente të tjera borxhi		0	0
(iv)	Investime të tjera financiare		0	0
	<b>Totali 3</b>		<b>13,964,143</b>	<b>10,688,740</b>
<b>4</b>	<b>Inventari</b>	<b>6</b>		
(i)	Lëndët e para	6	548,098	835,280
(ii)	Prodhim në proces	6	0	0
(iii)	Produkte të gatshme	6	0	0
(iv)	Mallra për rishitje	6	0	0
(v)	Parapagesat për furnizime	6	0	0
	<b>Totali 4</b>		<b>548,098</b>	<b>835,280</b>
<b>5</b>	<b>Aktivët biologjike afatshkurtra</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>6</b>	<b>Aktivët afatshkurtra të mbajtura për shitje</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>7</b>	<b>Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>Totali i aktiveve afatshkurtra (I)</b>		<b>15,103,746</b>	<b>11,857,590</b>
<b>II</b>	<b>Aktivët afatgjata</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>1</b>	<b>Investimet financiare afatgjata</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
(i)	Pjesëmarrje të tjera në njësi të kontrolluara		0	0
(ii)	Aksione dhe investime të tjera në pjesëmarrje		0	0
(iii)	Aksione dhe letra të tjera me vlerë		0	0
(iv)	Llogari/Kërkesa të arkëtueshme afatgjata		0	0
	<b>Totali 1.</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>2</b>	<b>Aktive afatgjata materiale</b>	<b>7</b>		
(i)	Toka	7	1,648,000	1,648,000
(ii)	Ndërtesa	7	43,576,041	45,869,517
(iii)	Makineri dhe pajisje	7	2,018,432	2,523,039
(iv)	Aktive të tjera afatgjata materiale (me vl.kontab.)	7	25,214	31,517
	<b>Totali 2</b>	<b>7</b>	<b>47,267,687</b>	<b>50,072,073</b>
<b>3</b>	<b>Aktivët Biologjike afatgjata</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>4</b>	<b>Aktivët afatgjata jomateriale</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
(i)	Emri i mire		0	0
(ii)	Shpenzimet e zhvillimit		0	0
(iii)	Aktive të tjera afatgjata jomateriale		0	0
	<b>Totali 4</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>5</b>	<b>Kapital aksionar i papaguar</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>6</b>	<b>Aktive të tjera afatgjata</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>Totali i aktiveve Afatgjata (II)</b>		<b>47,267,687</b>	<b>50,072,073</b>
	<b>TOTALI I AKTIVEVE (I + II)</b>		<b>62,371,433</b>	<b>61,929,663</b>

"UJESJELLES POLICAN" SHA

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

B	DETYRIMET DHE KAPITALI			
<b>I</b>	<b>Detyrimet Afatshkurtëra</b>			
<b>1</b>	<b>Derivativët</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>2</b>	<b>Huamarrjet</b>	<b>9</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
(i)	Huat dhe obligacionet afatshkurtra		0	0
(ii)	Kthimet/ripagesat e huave afatgjata	9	0	0
(iii)	Bono të konvertueshme		0	0
	<i>Totali 2</i>		0	0
<b>3</b>	<b>Huat dhe parapagimet</b>	<b>8</b>		
(i)	Të pagueshme ndaj furnitorëve	8	42,211,539	38,047,174
(ii)	Të pagueshme ndaj punonjësve	8	9,108,156	9,793,478
(iii)	Detyrime tatimore	8	29,452,754	24,185,732
(iv)	Hua të tjera	8	0	5,017,153
(v)	Parapagimet e arkëtuara	8	0	0
	<i>Totali 3</i>	8	80,772,449	77,043,537
<b>4</b>	<b>Grantet dhe të ardhurat e shtyra</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>5</b>	<b>Provizionet afatshkurtra</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
	<b>Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)</b>		<b>80,772,449</b>	<b>77,043,537</b>
<b>II</b>	<b>Detyrime afatgjata</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>1</b>	<b>Huat afatgjata</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
(i)	Hua, bono dhe detyrime nga qiraja financiare		0	0
(ii)	Bonot e konvertueshme		0	0
	<i>Totali 1</i>		0	0
<b>2</b>	<b>Huamarrje të tjera afatgjata</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>3</b>	<b>Provizionet afatgjata</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>4</b>	<b>Grantet dhe të ardhurat e shtyra</b>	<b>9</b>	<b>12,136,586</b>	<b>13,485,096</b>
	<b>Totali i detyrimeve afatgjata (II)</b>		<b>12,136,586</b>	<b>13,485,096</b>
	<b>Totali i detyrimeve (I+II)</b>		<b>92,909,035</b>	<b>90,528,633</b>
<b>III</b>	<b>Kapitali</b>			
<b>1</b>	<b>Aksionet e pakicës</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
	Kapitali që i përket aksionarëve të shoqërisë			
<b>2</b>	<b>mëmë</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>3</b>	<b>Kapitali aksionar</b>	<b>10</b>	<b>45,873,498</b>	<b>45,873,498</b>
<b>4</b>	<b>Primi i aksionit</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>5</b>	<b>Njësitë ose aksionet e thesarit (negative)</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>6</b>	<b>Rezerva statusore</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>7</b>	<b>Rezerva ligjore</b>		<b>0</b>	<b>0</b>
<b>8</b>	<b>Rezerva të tjera</b>		<b>7,440,885</b>	<b>7,440,885</b>
<b>9</b>	<b>Fitimet e pashpërndara</b>	<b>11.7</b>	<b>(81,913,354)</b>	<b>(76,238,962)</b>
<b>10</b>	<b>Fitimi (humbja) e vitit financiar</b>	<b>11.7</b>	<b>(1,938,630)</b>	<b>(5,674,392)</b>
	<b>Totali i kapitalit (III)</b>		<b>(30,537,602)</b>	<b>(28,598,971)</b>
	<b>TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT (I+II+III)</b>		<b>62,371,433</b>	<b>61,929,663</b>

"UJESJELLES POLICAN" SHA

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

**Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve të Periudhës 1 Janar 2013 deri më 31 Dhjetor 2013**

**(Bazuar ne klasifikimin e shpenzimeve sipas natyres)**

		Shëni me	Viti ushtrimor 2013	Ushtrimi paraardhes 2012
1	Shitjet neto	11.1	9,290,626	10,723,891
2	Të ardhura të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	11.2	14,348,510	12,975,746
3	Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatëshme dhe prodhimit në proces		0	0
4	Materialet e konsumuara	11.3	(7,272,880)	(8,157,107)
5	Kosto e punes	11.4	(13,650,519)	(13,713,891)
	<i>Pagat</i>		(11,637,000)	(11,691,591)
	<i>Shpenzimet per sigurimet shoqerore dhe shendetsore</i>		(2,013,519)	(2,022,300)
6	Amortizimi dhe zhvleresimet	8	(2,804,386)	(3,020,336)
7	Shpenzime te tjera	11.5	(4,426,941)	(4,841,092)
8	<b>Totali i shpenzimeve (shuma 4-7)</b>		<b>(28,154,726)</b>	<b>(29,732,426)</b>
9	<b>Fitimi apo humbja nga veprimtaria kryesore (1+2+3-8)</b>		<b>(4,515,590)</b>	<b>(6,032,789)</b>
10	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga njësitë e kontrolluara		0	0
11	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga pjesëmarrjet		0	0
12	Të ardhurat dhe shpenzimet financiare		0	0
12,1	<i>Të ardhurat dhe shpenzimet financiare nga investime të tjera financiare afatgjata</i>		0	0
12,2	<i>Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi</i>	11.6	8,472	21,076
12,3	<i>Fitimet (humbjet) nga kursi i këmbimi</i>	11.6	0	0
12,4	<i>Të ardhura dhe shpenzime të tjera financiare</i>	11.6	2,568,488	337,321
13	<b>Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare (12.1+/-12.2+/-12.3+/-12.4)</b>		<b>2,576,960</b>	<b>358,397</b>
14	<b>Fitimi (humbja) para tatimit (9+10+11+12+/-13)</b>		<b>(1,938,630)</b>	<b>(5,674,392)</b>
15	Shpenzimet e tatimit mbi fitimin		0	0
16	<b>Fitimi (humbja) neto e vitit financiar (14-15)</b>		<b>(1,938,630)</b>	<b>(5,674,392)</b>

*Pasqyrat Financiare lexohen së bashku me shënimet shpjeguese 6-16*

"UJESJELLES POLICAN" SHA

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

***Pasqyra e Fluksit monetar për Periudhën 1 Janar 2013 deri më 31 Dhjetor 2013***

Pasqyra e fluksit monetar – Metoda indirekte	She nime	Viti ushtrimor 2013	Ushtrimi paraardhes 2012
<b>Fluksi i monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit</b>			
<b>Fitimi para tatimit</b>	11.7	(1,938,630)	(5,674,392)
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimin	8	2,804,386	3,020,336
Humbje nga kembimet valutore			
Të ardhura nga investimet		0	0
Shpenzime per interesa		0	0
Rritje/rënie në tepricën e kërkesave të arkëtueshme nga aktiviteti si dhe e kërkesave të tjera	3,4	(3,275,404)	(3,317,924)
Rritje/renie në tepricën e inventarit	6	287,182	147,433
Rritje/renie në tepricën e detyrimeve për të paguar nga aktiviteti	9	3,728,912	7,311,362
<b>Mjetet monetare të perfituara nga aktivitetet</b>		<b>1,606,446</b>	<b>1,486,815</b>
Interesi i paguar	11	0	0
Tatimfitimi i paguar			
Rritje/renie e parapagimeve dhe e shpenzimeve të shtyra	7	0	0
<b><i>Mjete monetare neto nga aktiviteti i shfrytëzimit</i></b>		<b>1,606,446</b>	<b>1,486,815</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese</b>			
Blerje e shoqërisë së kontrolluar _____ minus parate e arkëtuara			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale		0	0
Të ardhura nga shitja e paisjeve		0	(8,617,592)
Interesi i arkëtuar			
Dividendet e arkëtuar			
<b><i>Mjete monetare neto e perdorur në aktivitetet investuese</i></b>		<b>0</b>	<b>(8,617,592)</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë financiare</b>			
Të ardhura nga emetimi i kapitalit aksioner			
Të ardhura nga huamarrje afatgjata	11	0	0
Pagesa e detyrimeve të qirase financiare		0	0
Dividendet e paguar			
Grante afatgjata dhe provizione afatgjata		(1,348,510)	6,759,610
<b><i>Mjete monetare neto e perdorur në aktivitetet financiare</i></b>		<b>(1,348,510)</b>	<b>6,759,610</b>
<b>Rritja/rënia neto e mjeteve monetare</b>		<b>257,935</b>	<b>(371,167)</b>
<b>Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël</b>		<b>333,570</b>	<b>704,737</b>
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël</b>		<b>591,505</b>	<b>333,570</b>



**“UJESJELLES POLICAN” SHA**

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

**Pasqyra e ndryshimeve të Kapitalit gjatë Periudhës 1 Janar 2013 deri më 31 Dhjetor 2013**  
**ne nje pasqyre te pakonsoliduar**

	Kapitali aksionar	Primi i aksionit	Aksione te thesarit	Rezerva ligjore statusore	Fitimi i pashpërndarë	Totali
<b>Pozicioni më 31 Dhjetor 2011</b>	45,873,498	-	-	7,440,885	(76,238,962)	(22,924,579)
Efkti ndryshimeve ne politikat kontabël	-	-	-	-	-	-
<b>Pozicioni i rregulluar</b>	45,873,498	-	-	7,440,885	(76,238,962)	(22,924,579)
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	(5,674,392)	(5,674,392)
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-	-	-	-
Emetimi i aksioneve(pjeseve te reja te kapitalit)	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-
<b>Pozicioni më 31 Dhjetor 2012</b>	45,873,498	-	-	7,440,885	(81,913,354)	(28,598,971)
Fitimi neto për periudhën kontabël	-	-	-	-	(1,938,630)	(1,938,630)
Dividentët e paguar	-	-	-	-	-	-
Emetim i kapitalit aksionar (pjeseve te reja)	-	-	-	-	-	-
Rritje e rezervës së kapitalit	-	-	-	-	-	-
Aksione te thesarit te riblera	-	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-	-
<b>Pozicioni më 31 Dhjetor 2013</b>	45,873,498	-	-	7,440,885	(83,851,985)	(30,537,602)

## “UJESJELLES POLICAN” SHA

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

### **SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE TE VITIT 2013**

#### **1. Informacione te pergjitheshme**

“UJESJELLES POLICAN” sh.a eshte krijuar si shoqeri anonime me vendim te gjykates se rrethit Gjyqsor Tirane nr.26593 date 29.01.2001. Aktiviteti kryesor i kesaj shoqerie eshte grumbullimi perpunimi dhe shperndarja e ujit te pijshem.

#### **2. Permbledhje e politikave kontabel**

##### **Bazat e pergatitjes së pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë pergatitur në përputhje me ligjin shqiptar “Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato jane pergatitur mbi bazen e parimit te koston historike, duke e kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit te te drejtave te kostatuara. Ato paraqiten ne monedhen vendase, Lekë Shqiptar (“lekë”).

##### **Parimet kontabile më domethënëse që janë pëdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:**

##### **Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre**

Mjetet monetare përfshijnë mjetet monetare në arkë, banke dhe depozitat me afat. Ekuivalentët e mjeteve monetare janë investime afatshkurtra, shumë likuide dhe të gatshme për t’u konvertuar në shuma të njohura të mjeteve monetare dhe të cilat nuk janë objekt i një rreziku domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Veprimtari të shfrytëzimit janë aktivitetet bazë të prodhimit të të ardhurave të njësisë ekonomike dhe aktivitete të tjera të cilat nuk janë aktivitete investuese ose financuese.

Veprimtari investuese janë blerja, nxjerrja e aktiveve afatgjata dhe investime të tjera që nuk përfshihen në ekuivalentët e mjeteve monetare.

Aktivite financuese janë aktivitetet që cojnë në ndryshime në masën dhe përbërjen e kapitalit neto të kontribuar dhe të huamarrjeve afatgjata ose aftashkurtëra nga njesia ekonomike.

Overdraftet bankare konsiderohen si financim, si flukse nga veprimtaria financiare, dhe si rrjedhim përjashtohen nga mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare.

Paraqitja në bilancin kontabël korespondon me mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare sipas përkufizimit të mësipërm.

##### **Aktivët financiarë**

Shoqëria i klasifikon aktivet financiare në Llogari/Kërkesa të arkëtueshme nga klientët dhe në Llogari/Kërkesa të tjera të arkëtueshme. Drejtimi vendos për klasifikimin në momentin e njohjes fillestare. Aktivët financiarë paraqiten në bilanc me vlerën neto, pakesuar nga zhvlerësimi nëse ka.

Llogari/Kërkesa të arkëtueshme njihen si aktive atëherë kur njesia ekonomike bëhet palë e një kontrate dhe, si rrjedhim, ka një të drejtë ligjore për të marrë mjete monetare nga klientët e saj. Njohja fillestare e

## “UJESJELLES POLICAN” SHA

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese

*Shumat shprehen në lekë*

kërkesave për t'u arkëtuar nga klientët ndodh derisa mallrat ose shërbimet e porositura janë nisur për tek klienti, kanë mbërritur tek klienti ose shërbimi është kryer. Kërkesat për tu arkëtuar vlerësohen në hyrje me kosto dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar (kosto fillestare minus arkëtimet e bëra, minus zhvlerësimet nga borxhi i keq nëse ka) pavarësisht nga qëllimi i njësisë për t'i mbajtur ato deri në maturim. Një zhvlerësim për rënie vlere të të drejtave për t'u arkëtuar krijohet atëherë kur ekzistojnë rrethana që Shoqëria nuk do të jetë në gjendje që t'i arkëtojë të gjitha shumat ashtu siç ishte parashikuar në termat fillestare të kërkesave për tu arkëtuar. Konsiderohen tregues të rënies së vlerës së llogarive të arkëtueshme, vështirësi të rëndësishme financiare të debitorit, debitori ka hyrë në rrugën e falimentimit ose riorganizimit financiar, moskryerja apo vonesat në pagesa etj. Shoqëria vlerëson çdo vit mundësinë e arkëtimit të llogarive të arkëtueshme për secilin klient.

Kërkesa të tjera të arkëtueshme njihen kur njësia ka një të drejtë për të marrë mjete monetare ose përfitime në të ardhmen si pasojë e një ngjarje të ndodhur, përveç shitjes, dhe kur vlera e përfitimeve matet në mënyrë të besueshme. Kërkesat e tjera të arkëtueshme vlerësohen në hyrje dhe në bilanc me të njëjtën parime si dhe llogaritë e arkëtueshme.

### **Transaksionet me monedhat e huaja**

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Diferencat nga konvertimi, fitimet ose humbjet, regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në zërin “Të tjera të ardhura (shpenzime) financiare”. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në termat e koston historike dhe nuk rivlerësohen. Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2013 janë 1 euro=140.20 leke dhe 1 dollar=101.86 leke.

### **Inventarët**

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK-4 “Inventarët”, kur shoqëria i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërish, kur mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet në lidhje me to, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme.

Në hyrje inventarët e mallrave dhe materialeve vlerësohen me koston e tyre që përfshin tërësinë e çmimeve të blerjes dhe të shpenzimeve të bëra për të sjellë inventaret në kushte magazinimi, kur këto kosto mund të identifikohen me besueshmëri.

Në bilanc inventarët paraqiten të vlerësuara me vlerën neto, pra më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus koston e parashikuar të shitjes.

### **Aktivet afatgjata materiale**

Aktivet afatgjata materiale (AAM-të) bazohen në modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta në zërin “tepricë nga rivlerësimi”. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Amortizimi për të gjitha grupet, llogaritet dhe njihet me metodën e vlerës së mbetur, me norma të cilat janë të përafërta me jetegjatesinë mesatare të parashikuar të përdorimit. Toka dhe aktivet në proces nuk amortizohen. Normat e përdorura janë në ndertesa 5 % dhe për aktivet e tjera 20% të vlerës së mbetur

## “UJESJELLES POLICAN” SHA

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

### Detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata

Detyrimet shoqëria i klasifikon në afatshkurtra dhe afatgjata, bazuar në percaktimet e SKK-2. Huamarrjet afatshkurtër njihen fillimisht me vlerën e drejtë, pa përfshirë kostot e transaksionit. Huat më pas vlerësohen me koston e amortizuar: çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas. Huat klasifikohen si detyrime afatshkurtra, përveç rastit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për të shtyrë shlyerjen e detyrimit për të paktën 12 muaj pas datës së bilancit kontabël. Llogaritë të pagueshme ndaj furnitoreve dhe detyrimet e tjera tregtare, njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas në bilanc paraqiten të vlerësuara me koston e amortizuar.

Detyrimet ndaj shtetit për tatimet dhe për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore paraqiten me shumën e tyre të llogaritur sipas kërkesave ligjore në fuqi në datën e ndërtimit të pasqyrave financiare.

Huat afatgjata vlerësohen në hyrje me koston dhe paraqiten në bilanc të vlerësuara me koston e amortizuar. Çdo diferencë midis ripagesave (neto nga kostot e transaksionit) dhe vlerës së shlyerjes së detyrimit, njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së huas.

### Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara.

Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve atëherë kur ngjarja detyruese ka ndodhur dhe shoqëria pret të dalin aktive për shlyerjen e tyre në të ardhmen. Shoqëria zbaton parimin e krahasimit të të ardhurave me shpenzimet brenda të njëjtit ushtrim kontabel. Shpenzimet njihen kur kryhen dhe realizohen të ardhura prej tyre, pavarësisht nëse janë faturuar apo paguar ato.

### Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit për tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2013 është 10 % aq sa ka qene në ushtrimin e mëparshëm. Shoqëria nuk zbaton kërkesat e SKK-11 për tatimin e shtyrë.

### **3. Aktive monetare (likujditete në banke dhe arke)**

Gjendjet e mjeteve monetare, në leke dhe valute, në datat 31 Dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 janë si më poshte:

**“UJESJELLES POLICAN” SHA**

**Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese**

*Shumat shprehen në lekë*

Emertimi i Llogarise	Monedha	Gjendja ne 31.12.2013		Gjendja ne 31.12.2012	
		Ne leke	Ne valute	Ne leke	Ne valute
Llogari bankare	leke	583,193		295,423	
Arka	leke	8,312		38,147	
<b>Shuma Mjete monetare</b>		<b>591,505</b>	<b>0</b>	<b>333,570</b>	<b>x</b>

Gjendjet e llogarive te mjeteve monetare te paraqitura ne pasqyrat financiare jane te njejta me te dhenat e kontabilitetit rrjedhes dhe konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare te bankave perkatese dhe inventaret fizike.

**4. Aktive te tjera financiare afatshkurtera- Llogari/Kerkesa te arketueshme**

Llogari/Kerkesa te arketushme jane te perbera si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Kliente per mallra, produkte e sherbime	12,968,453	10,390,036
Zhvleresimi i te drejtave ndaj klienteve per mallra, prod.e sherb		
Kliente per aktive afatgjata		
Zhvleresimi i te drejtave ndaj klienteve per aktive afatgjata		
<b>Shuma Kerkesa te arketueshme</b>	<b>12,968,453</b>	<b>10,390,036</b>

“Kliente per mallra produkte e sherbime” pasqyrojne vleren e faturave te pa likujduara ne fund te ushtrimit. Drejtimi mendon se shumate e paraqitura ne llogarite individuale jane te arketueshme dhe nuk parashikon renie ne vlere.

**5. Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme**

Llogari/Kerkesa te tjera te arketueshme jane te perbera si vijon :

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Shteti per tatime dhe taksa		
Shteti-Tatim mbi fitimin (teprica debitore)	0	0
Shteti-TVSH per tu marre	0	0
Shteti -Tatime te tjera (teprica debitore)	0	0
Shteti Tvsh per tu rregulluar (teprica debitore)	0	0
Shteti Sigurime Shoqërore Shëndetsore(teprica debitore)		
Personeli (teprica debitore)	995,690	298,704
<b>Shuma</b>	<b>995,690</b>	<b>298,704</b>

Drejtimi gjykon se te gjitha kerkesat do te arketohen ne nje periudhe afatshkurter me vleren e tyre nominale dhe nuk parashikon renie ne vlere.

**“UJESJELLES POLICAN” SHA**

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

**6. Inventari**

Inventari është i përbërë si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
<b>Lende te para</b>		
Materiale te para dhe materiale te tjera	168,605	455,787
Inventari i imet dhe ambalazhi (afatshkurter)	379,493	379,493
<b>Shuma Lende te Para</b>	<b>548,098</b>	<b>835,280</b>
<b>Prodhim ne Proçes</b>		
Punime ne proçes	0	0
Sherbime ne proçes		
<b>Shuma Prodhim ne Proçes</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Produkte te Gateshme</b>	0	0
<b>Mallra per Rishitje</b>	0	0
<b>Parapagime per furnizime</b>	0	0
<b>Shuma inventar</b>	<b>548,098</b>	<b>835,280</b>

Vlerat e inventarit të paraqitura me sipër përputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike të kryera në fund të ushtrimit 2013. Veprimet ekonomike që lidhen me hyrjet e daljet janë tranzituar në llogaritë e rezultatit me mënyrën e inventarit të përhershëm. Vlerat e inventarit të paraqitura me sipër përputhen me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike të kryera në fund të ushtrimit 2013. Si politike kontabel në përcaktimin e kostos së inventarit është përdorur metoda “FIFO”. Drejtimi gjykon se vlera e paraqitur është vlera më e ulët mes kostos së marrjes dhe vlerës neto të realizueshme dhe nuk ka nevojë për zhvlerësime të tij.

**7. Aktive afatgjata materiale**

Aktivët Afatgjata Materiale (AAM-te) përbehen si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertime	Instalime teknike, makineri pajsje, etj.	Mjete transporti	Pajsje zyre e informatike	Inventar i imet afatgjate	Totali
Kosto e AAM me 01.01.2013	1,648,000	104,118,429	22,060,082	990,000	264,700	0	129,081,211
Shtesat	0	0	0	0	0	0	0
Pakesimet	0	0	0	0	0	0	0
Kosto e AAM me 31.12.2013	1,648,000	104,118,429	22,060,082	990,000	264,700	0	129,081,211
Amortizimi AAM 01.01.2013	0	58,248,912	19,726,205	800,838	233,183	0	79,009,138
Amortizimi ushtrimor	0	2,293,476	466,775	37,832	6,303	0	2,804,386
Amortizimi per daljet AAM	0	0	0	0	0	0	0
Amortizimi i AAM me 31.12.2013	0	60,542,388	20,192,980	838,670	239,486	0	81,813,524
Vlera neto e AAM 31.12.2012	1,648,000	45,869,517	2,333,877	189,162	31,517	0	50,072,073
Vlera neto e AAM 31.12.2013	1,648,000	43,576,041	1,867,102	151,330	25,214	0	47,267,687

**“UJESJELLES POLICAN” SHA**

**Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese**

*Shumat shprehen në lekë*

Si politike kontabel për kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos (SKK-5). Vlerat dhe klasifikimi në grupe të AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mesiperme janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimeve fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit dhjetor 2013. Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes në inventar është bërë me koston e marrjes dhe në datën e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Drejtimi ka gjykuar se përgjithësisht për këtë ushtrim kontabel, nuk ka shenja të rënies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime. Metodatat dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë lineare (shih shënimin nr.2). Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijtë e përcaktuar për efekte fiskale.

**8. Detyrimet afatshkurtera-Huate dhe parapagimet**

Huate dhe parapagimet përbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
<b>Te pagueshme ndaj furnitoreve</b>		
Furnitore për mallra, produkte e shërbime	42,211,539	38,047,174
<b>Te pagueshme ndaj punonjësve</b>		
Detyrime ndaj personelit për paga dhe shërbime	9,108,156	9,793,478
Paradhenie për punonjësit		
<b>Shuma Te pagueshme ndaj punonjësve</b>	9,108,156	9,793,478
<b>Detyrime tatimore</b>		
Detyrime për sigurime shoqërore shëndetësore	20,326,034	14,129,152
Shteti për tatime e taksa		
Akciza	0	0
Tatim mbi të ardhurat personale	6,749,944	4,560,401
Tatim mbi fitimin	0	0
Tvsh për tu paguar	2,376,776	5,496,179
Taksa lokale	0	0
Të tjera tatime për tu paguar	0	0
Tatim në burim	0	0
<b>Shuma Shteti për tatime e taksa</b>	9,126,720	10,056,580
<b>Shuma Detyrime Tatimore</b>	29,452,754	24,185,732
<b>Hua të tjera</b>		
Debitore të tjera kreditore të tjera	0	5,017,153
Dividende për tu paguar	0	0
<b>Shuma hua të tjera</b>	0	5,017,153
<b>Parapagimet e arketuara</b>	0	0
<b>Shuma Huate dhe Parapagimet</b>	<b>80,772,449</b>	<b>77,043,537</b>

“Të pagueshme ndaj furnitorëve” pasqyron detyrimet ndaj furnitorëve për blerjen e mallrave e shërbimeve pa u likuiduar në fund të ushtrimit. Shoqëria ka përgatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike është e barabartë me shumën e llogarive analitike të mbajtura për çdo furnitor. Drejtimi mendon se të drejtat e furnitorëve janë të vlerësuara realisht.

“Të pagueshme ndaj personelit për paga e shërbimeve” përbehet nga detyrimi i papaguar ndaj personelit në 31.12.2013. “Detyrimet për sigurime shoqërore e shëndetësore” përfaqësojnë detyrimin për sigurimet

## “UJESJELLES POLICAN” SHA

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

shoqerore e shendetesore te muajit dhjetor 2013. “Shteti per tatim taksa” pasqyrojne detyrimin per tatimin mbi vleren e shtuar, tatimin mbi te ardhurat personale, detyrimet e kontabilizuara dhe te papaguara te akt-vleresimeve tatimore dhe tatim fitimin e rezultuar nga rakordimet perfundimtare, ne 31 Dhjetor 2013. Ne “Hua te tjera” jane paraqitur detyrimet per marrdhenie financiare te perkoshme.

### 9. Grantet dhe te Ardhurat e Shtyra(Afatgjata)

Grantet dhe te ardhurat e shtyra (afatgjata) perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Grante afatgjata	12,136,586	13,485,096
Interesa pasive te llogaritura		
Te ardhura te periudhave te ardheshme		
Shuma Grantet dhe te ardhurat e shtyra afatgjata	12,136,586	13,485,096

Grantet afatgjata perfaqesojne vleren e mbetur te grandeve afatgjata te mara falas.

### 10. Kapitalet e veta

Kapitali themeltar perbehet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Kapitali i paguar	45,873,498	45,873,498
Kapitali i nenshkruar i papaguar		
Shuma Kapitali themeltar	45,873,498	45,873,498

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2013 ai eshte 45.873.498 leke.

### 11. Fitimi(humbja) e vitit financiar

#### 11.1 Shitjet neto

Shitjet neto perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Shitje e produkteve te gateshme	9,290,626	10,723,891
Shitja e punimeve dhe e sherbimeve	-	-
Shitje mallrash	-	-
Shuma Shitje neto	9,290,626	10,723,891

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, te zhveshura nga TVSH-ja.

#### 11.2 Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

Te ardhura te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit perbehen si vijon:



**“UJESJELLES POLICAN” SHA**

**Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguse**

*Shumat shprehen në lekë*

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
<b>Te ardhura nga shitjet e tjera</b>		
Lidhje kontrate	0	45,000
Shitje materiale	0	0
Te tjera pakesim I kreditoreve	0	0
<b>Shuma Te ardhura nga shitjet e tjera</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Puna e kryer dhe e kapitalizuar</b>	<b>0</b>	<b>45,000</b>
<b>Te ardhura nga grantet</b>	<b>13,000,000</b>	<b>11,690,044</b>
<b>Te ardhura te tjera (Kuota pjese e granteve afatgjata)</b>	<b>1,348,510</b>	<b>1,240,702</b>
<b>Te ardhurat neto nga shitja e aktiveve</b>		
Te ardhura nga shitja e aktiveve		
Vlera kontabel Neto e mbetur e AAM		
<b>Shuma Te ardhurat neto nga shitja e aktiveve</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Rimarrje e provizionit per zhvleresimin e klienteve</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Fitimi neto nga ndryshimi i kursit te kembimit</b>		
<b>Shuma Te ardhurat e tjera (nga veprimtarite e shfrytezimit)</b>	<b>14,348,510</b>	<b>12,975,746</b>

**11.3 Shpenzimet per Mallrat, lendet e para dhe sherbimet**

Shpenzimet per Mallrat, lendet e para dhe sherbimet perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Blerje/Shpenzime te materialeve	0	0
Blerje/Shpenzime te materialeve te tjera	576,000	592,544
Blerje/Shpenzime mallrash e sherbimesh	0	0
Blerje/Shpenzime te tjera	6,696,880	7,564,563
<b>Shuma Mallrat lendet e para dhe sherbimet</b>	<b>7,272,880</b>	<b>8,157,107</b>

Konsumi i materialeve, punimeve e sherbimeve, te pasqyruara ne dokumentat justifikues i perkasin vitit 2013 dhe jane rregjistruar me shumate e paguara ose te pagueshme.

**11.4 Shpenzime te personelit**

Shpenzime te personelit perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
Pagat dhe shperblimet e personelit	11,637,000	11,691,591
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	2,013,519	2,022,300
Kontribute dhe kuota te tjera per personelin	0	0
<b>Shuma Shpenzime te personelit</b>	<b>13,650,519</b>	<b>13,713,891</b>

Kostoja e punesimit, page dhe sigurime shoqerore, eshte pasqyruar si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar.

"UJESJELLES POLICAN" SHA

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese

Shumat shprehen në lekë

**11.5 Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit**

Shpenzimet e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit perbehen si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
<b>Sherbime nga te trete</b>		
Sherbim nga te trete	0	0
Qira	249,201	263,998
Mirembajtje riparime	835,448	971,788
Sigurime	0	66,886
Honorare	105,000	102,000
<b>Shuma sherbim nga te trete</b>	<b>1,189,649</b>	<b>1,404,672</b>
<b>Sherbime te tjera</b>		
Paga per keshillin mbikqyres	1,330,900	1,326,000
Te tjera	160,544	192,330
Personel jashte njesise	0	0
Shpenzime per ERU	0	0
Udhetime e Dieta	0	43,300
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	241,748	330,000
Shpenzime transporti	90,000	0
Shpenzime per sherbimet bankare	0	0
Shpenzime rroba pune per punonjesit	220,000	220,000
Shpenzime ushqimi punonjeseve	1,042,100	1,050,100
Materiale kancelari etj	0	0
Subvecione te dhena	0	0
Shpenzime te tjera per personelin	0	100,682
<b>Shuma Sherbime te tjera</b>	<b>3,085,292</b>	<b>3,262,412</b>
<b>Kuota e shpenzimeve per tu shpendare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Tatime dhe taksa</b>		
Taksa dhe tarifa vendore	152,000	154,008
Tatime te tjera	0	0
<b>Shuma Tatime dhe taksa</b>	<b>152,000</b>	<b>154,008</b>
<b>Gjoha demshperblime</b>	<b>0</b>	<b>20,000</b>
<b>Shpenzime nga falja e debitoreve sipas ligjit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>Humbje nga rivleresimi/Shitja e aktiveve</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Te ardhura nga shitja e aktiveve	0	0
Vlera kontabel Neto e mbetur e AAM	0	0
<b>Shuma shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit</b>	<b>4,426,941</b>	<b>4,841,092</b>

Shpenzimet e tjera nga veprimtarite e shfrytezimit te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumen e paguar ose te pagueshme.

**“UJESJELLES POLICAN” SHA**

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese

*Shumat shprehen në lekë*

Taksat lokale e taksa e tatime te tjera qe lidhen me biznesin jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit.

**11.6 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare**

Te ardhurat dhe shpenzimet financiare jane paraqitur si difference e te ardhurave me shpenzimet financiare:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
<b>Te ardhurat dhe shpenzimet nga interesat</b>		
Te ardhurat nga interesat	8,472	21,076
Shpenzime per interesa	0	0
<b>Shuma te ardhura dhe shpenzime nga intersat</b>	8,472	21,076
<b>Fitimet/humbjet nga kursi i kembimit</b>		
Fitim nga kembimet valutore	0	0
Humbje nga kembimet valutore	0	0
<b>Shuma Fitimet/humbjet nga kursi i kembimit</b>	0	
Te ardhura dhe shpenzime te tjera financiare	2,568,488	337,321
Te ardhura dhe shpenzime finaciare afatgjata		
<b>Shuma te ardhura dhe shpenzime financiare</b>	<b>2,576,960</b>	<b>358,397</b>

**11.7 Shpenzimet e Tatim fitimit**

Shpenzimet e tatimit mbi fitimin jane si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2013	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2012
<b>I FITIMI NETO PARA TATIMT</b>	(1,938,630)	(5,674,392)
<b>II SHPENZIME TE PA ZBRITESHME (+)</b>	<b>0</b>	<b>20,000</b>
1. Amortizimi tej normave fiskale		
2. Shpenzime per pritje e dhurime tej kufirit tatimor		
3. Gjoha, penalitete, demshperblime	0	20,000
4. Provizione qe nuk njihen		
5. Shpenzime pa dokumenta te rregullta		
6. Te tjera (falja e debitoreve sipoas ligjit)	0	0
<b>III PJESA E HUMBJES SE MBARTUR (-)</b>		
<b>IV FITIM (HUMBJA) TATIMORE (I+II-III)</b>	(1,938,630)	(5,654,392)
<b>V SHPENZIMET E TATIMIT MBI FITIMIN</b>		
<b>VI FITIMI(HUMBJA) NETO E USHTRIMIT</b>	<b>(1,938,630)</b>	<b>(5,674,392)</b>

**12. Transaksione te paleve te lidhura**

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksioni dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre, ne 31 dhjetor 2013 dhe 31 Dhjetor 2012 nuk ka transaksione me palet e lidhura.

**“UJESJELLES POLICAN” SHA**

Pasqyrat financiare për periudhën ushtrimore që mbyllet më 31.12.2013 dhe shënimet shpjeguese

*Shumat shprehen në lekë*

**13. Ngjarjet pas dates se bilancit dhe vazhdimesia e shfrytezimit**

Nga analiza e gjendjes dhe performances financiare, rezulton se asnje ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas dates se miratimit të pasqyrave financiare të cilat do të ndikonin në pasqyrat financiare të vitit 2013.

**14. Shifrat krahasuese**

Shifrat krahasuese të deklaruara në pasqyrat financiare 2012 janë të njëjta me ato të prezantuara në vitin aktual 2013.

**H A R T U E S I**

**ARIF SPAHO**

**PER “UJESJELLES POLICAN” SH.A**

**D R E J T O R I**

**REFIK SPAHO**

